

66-); KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; OMPE, *Mbetjet...*, FDH-15297; OMPE, *Regjistri i konsoliduar...*, FDH-32367.

Safet (Ramadan) Hysenaj

(20.09.1967, shqiptar nga Petrova/Petrovo, komuna e Shtimes/Štimlje)

Safeti me prindërit e vet jetonin në Petrovë/Petrovo. Nuk ishte i martuar. Pjesëtarë të UÇK-së e kanë marrë nga shtëpia në mbremjen e datës 20.06.1998. I ati ka mësuar më vonë se pjesëtarë të UÇK-së i kishin thënë Safetit se kishte ardhur koha që ai të shkonte me ta. Në fshat përfllite se Safetin e kishin marrë ngase bashkëpunonte me serbët.

Safeti ka qenë i mbyllur në burgun e UÇK-së në **Lapushnik/Lapušnik**. Në datën 25 apo 26.07.1998, Haradin Balaj dhe pjesëtarë të UÇK-së, i quajtur Murrizi, e kanë pushkatuar Safetin, si dhe nëntë të burgosur të tjerë në **Malet e Berishës/Berišine planine**. Mbetjet mortore të Safetit u zbuluan në vendin e vrasjes në muajin gusht të vitit 2001. Familjarët i kanë marrë mbetjet e tij mortore më 02.03.2005. Dy ditë më vonë, i kanë varrosur ato në varrezat e Petrovës/Petrovo. Për vrasjen e Safetit dhe tetë të burgosur të tjerë, Gjykata Ndërkombëtare për Krime Luftë në ish Jugosllavi e ka dënuar Haradin Balajn me 13 vjet burgim.

Burimet: ICTY, IT-03-66 (F. Limaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 30.11.2005, [http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=P-ravdaIReforma&int_cid=119&cat=Transkripti/Predmet-Limaj-i-drugi-\(-IT-03-66-\);](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=P-ravdaIReforma&int_cid=119&cat=Transkripti/Predmet-Limaj-i-drugi-(-IT-03-66-);) deklarata H.H, FDH-34657; deklarata I.H, FDH-2764; deklarata I.H, FDH-23600; FHP, *Haški tribunal, Suđenje Slobodanu Miloševiću*, XVIII, 124; ICTY, IT-03-66-T, (F. Limaj dhe të tjerë), transkript, 07.03.2005, <http://www.hlc-rdc.org/uploads/editor/file/Transkripti/Limaj/Limaj%20-%20svedok%20Shukri%20Buja%20-%2007.03.2005.pdf>; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), EX.312.55, FDH-31063; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; OMPE, *Mbetjet...*, FDH-15297; OMPE, *Regjistri i konsoliduar...*, FDH-32367.

Bashkim (Islam) Rashiti

(13.07.1964, shqiptar nga Godanci i Epërm/Gornje Godance, komuna e Shtimes/Štimlje, tre fëmijë)

Në javën e parë të muajit korrik të vitit 1998, te daja i Bashkimit, Faiku, ka ardhur Jet Hasani, ushtar i UÇK-së, dhe i ka thënë atij se Bashkimi duhej të paraqitej në shtabin e UÇK-së në Kroimirë/Krajmrovce [Lipjan/Lipljan]. Ditën e shtunë, më 11.07.1998, Bashkimi e ka përcjellë bashkëshorten Tahiren në punë në Shtime/Štimlje. Në fund i tha se do të shkonte të paraqitej në UÇK. Ishte kjo hera e fundit që Tahirja e shihte atë të gjallë.

Bashkimin e kanë vërejtur më vonë në kampin e UÇK-së në **Llapushnik/Lapušnik**. Ishte i mbyllur në një qilar. E kanë pushkatuar së bashku me grupin prej nëntë të burgosurish më 25 apo 26.07.1998, në **Malet e Berishës/Berišine planine** [Malishevë/Mališevo]. Mbetjet mortore të Bashkimit janë gjetur në muajin shtator të vitit 2001 në varrezën masive, në afërsi të vendit të ekzekutimit. Familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Bashkimit në varrezat e fshatit Godanc i Epërm/Gornje Godance më 29.03.2005. Për vrasjen e Bashkimit dhe tetë të burgosur të tjerë, Gjykata Ndërkombëtare për Krime Luftë në ish Jugosllavi e ka dënuar Haradin Balajn me 13 vjet burgim.

Burimet: deklarata I.R, FDH-23591; ICTY, IT-03-66 (F. Limaj dhe të tjerë), Ex.223, FDH-36661; ICTY, IT-03-66-T, (F. Limaj dhe të tjerë), transkript, 15.11.2004, <http://www.hlc-rdc.org/uploads/editor/file/Transkripti/Limaj/Limaj%20-%20Uvodna%20rec%20Tuzilastva%20-%2015.11.2004.pdf>; ICTY, IT-03-66 (F. Limaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 30.11.2005, [http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=119&cat=Transkripti/Predmet-Limaj-i-drugi-\(-IT-03-66-\);](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=119&cat=Transkripti/Predmet-Limaj-i-drugi-(-IT-03-66-);) ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), EX.312.55, FDH-31063; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; OMPE, *Mbetjet...*, FDH-15297; OMPE, *Regjistri i konsoliduar...*, FDH-32367.

Lutfi (Ahmet) Xhemshiti

(9.05.1964, shqiptar nga fshati Breg i Zi/Crni Breg, komuna e Lipjanit/Lipljan, pylltar, katër fëmijë)

Lutfiu ka jetuar në fshatin Breg i Zi/Crni Breg [Lipjan/Lipljan], së bashku me bashkëshorten Bahrijen dhe katër fëmijët